INSTRUKSION PËR BLERJET NË INTERNET

1. Diversifikoni portofolin e llogarivë bankare – Nëse bleni shpesh në internet është e domosdoshme të siguroni humbjen e parave tuaja nga mashtrimet kibernetike ndërmjet diversifikimit të llogarisë së lidhur me kartën tuaj. E mira është të mbani dy llogari, një për blerjet në internet (të lidhur me kartën) dhe të dytën një depozitë elastike ose llogari rrjedhëse. Në llogarinë e lidhur me kartën për blerje në internet transferoni fonde nga llogaria e dytë ndërmjet e-banking/Mobile Banking, transferoni vetëm aq sa ju duhet për blerjen, kjo për arsye që të ulni riskun nëse mund të vidhen të dhënat e kartës gjatë transaksionit.

2. Limiti për blerje në internet – Për të ulur riskun mos mbani limit e lartë për blerje në internet, mbani limit aq sa ju duket e arsyeshme për transksionet që do kryheni. Nëse do ju duhet një limit me i lartë për një rast në vlerë më të madhe vendosni një limit të lartë me afat kohor dhe kur afati të skadojë do të keni limitin e mëparshem.

3. SMS Banking – Të gjithë klientët që kryejnë blerje në internet duhet të paisen me SMS banking dhe do të njoftohen me SMS për të gjitha veprimet me kartë. Nëse klienti nuk njeh transaksionin që i vjen me SMS duhet të telefonojë menjëhere në bankë që të kryhet bllokimi i kartës derisa klienti të japi konfirmimin përfundimtar nëse e njeh transksionin. Ky shërbim parandalon në kohë rastet kur do të vidheshin të dhënat e kartës dhe do tentohej të përdoreshin në faqe të ndryshme, me bllokimin e kartës nuk mund të kryhen më veprime të paautorizuara.

QËNDRA E SHËRBIMIT TË CILËSISË E Hënë – E Shtunë 09:00 – 19:00
0800 48 48 (pa pagese) +355 (0)68 40 12121; +355 (0)69 40 12121

4. Zgjidhni faqe të besueshme – Faqet e mëdha tregtare për të cilët ju keni dëgjuar, në përgjithësi kanë siguri të lartë. Psh kjo është një arsye pse Amazon, Ebay dhe faqe të tjera dominojnë në ditën e "Black Friday" (është dita kur tregtarët kanë uljet më të mëdha gjatë vitit). Nëse keni kryer njëherë blerje në këto faqe dhe jeni të kënaqur nga siguria dhe shërbimi mundohuni të bëni blerje përsëri. Kjo do të thotë që sa pak tregtarë kanë të dhënat tuaja të rregjistruara.

5. Bleni vetëm nga faqe të enkriptuara (të sigurta) – Kontrolloni në kokën e adresës së faqes, a është faqja e sigurt dhe evitoni kompjuterat publikë gjatë blerjeve tuaja. Shumica e browser-ave do ju shfaqin informacionin e sigurisë së faqes. Nëse adresa do ju shfaqet me një prefiks 'HTTPS', kjo do të thotë që lidhja është e enkriptuar. Nëse një browser nuk detekton një lidhje të sigurt kjo faqe mund të jetë e paenkriptuar dhe persona të paautorizuar (hakerat) mund të marrin të dhënat tuaja të trasmetuara ne këtë faqe.

OTP Bank Albania
Twin Towers
Bul. "Dëshmorët e Kombit"
Kulla 1, Kati 9
Tirana, Albania
Tel. +355 4 2 280 442/3
Mob. +355 68(69) 40 12 121
Fax. +355 4 2 280 441
www.otpbank.al

Shumica e browser-ave kur janë të sigurtë kanë simbolin e drynit (Padlock si shëmbulli poshtë), nëse ky simbol mungon faqja nuk është e sigurt dhe mund të ketë risk.



6. Fshini prezencën tuaj online – Nëse nuk ju nevojitet me një llogari në një faqe tregtare atëherë fshijeni. Të ruani të dhënat tuaja në të gjithë llogarite e faqeve tregtare është një ftesë e mirë për vjedhje/humbje sidomos kur nuk mbani mënd kush ka të dhënat tuaja dhe për cfarë qëllimesh do i përdori.

7. Kontrolloni shpesh llogaritë tuaja në internet – Nëse një mashtrim ka ndodhur, mënyra më e shpejt për ta kapur është që të kontrolloni përditë llogaritë tuaja në internet (psh llogarinë tuaj në PayPal). Sidomos nëse ju jeni duke bërë blerë te shpeshta online ose gjatë kohes së pushimeve periudhë në të cilën numri i bjerjeve shtohet. Një kërkim i shpejtë në Google me emrin e faqes e ndjekur me fjalën 'hack ' mund t'ju ndihmojë të indentifikoni nëse faqe të caktuara të përdorura shpesh nga ju kanë pësuar ndonjë atak kompjuterik së fundmi.

Gjithashtu kontrolloni vazhdimisht llogarinë e kartës që të identifikoni transaksione te paautorizuara nga ju.

8. Mos vizitoni faqe nëse nuk i verifikoni identitetin – Faqet të cilat nuk janë të njohura kanë risk me të madh për mashtim. Mbi 40.000 faqe të rreme që shisnin aplikacione elektronike u mbyllën nga autoritetet, askush nuk do të donte të ishte pre e këtyre mashtrimeve.

Verifikoni identitetin e faqes ku do kryeni blerje me anë te link-ut te më poshtëm:
http://www.scamadviser.com/

9. Përdorni fjalëkalime të sigurta – Shumë faqe do ju shtyjnë të krijoni një fjalëkalim të sigurt, por është mirë të vendosni fjalëkalim edhe në ato faqe të cilat nuk e kanë të detyrueshme. Është e lehtë të vendosësh një fjalëkalim të sigurt, sa më shume karaktere të kete fjalekali aq më i sigurt është (të paktën 8 karaktere). Mos përdorni vetëm germa, përdorni edhe gërma kapitale, numra dhe shënja pikësimi. Mos vendosni fjalëkalime që mund të gjënden lehtë si psh. '123456'.

10. Mos përdorni të njëjtin fjalëkalim mbi dy herë – Mund të jetë e bezdisshme të mbash mënd fjalëkalimet në faqe të ndryshme në internet por programe si 'iCloud Keychain' dhe '1Password' do ju ndihmojnë të mbani mënd fjalëkalimet. Këto programe ruajnë të enkriptuar (të sigurtë) fjalëkalimet tuaja duke lehtësuar hapjen e faqeve ku jeni regjistruar.

11. Shmangni ofertat me e-mail – Mund të jetë një rast i mirë karremi. Këto oferta mund të jenë të vështira për tu verifikuar si të padëmshme dhe thjeshtë mund tju mashtrojnë për ti dhënë të dhënat tuaja. Nëse jeni dyshues kontaktoni shitësin duke përdorur të dhënat në

OTP Bank Albania
Twin Towers
Bul. "Dëshmorët e Kombit"
Kulla 1, Kati 9
Tirana, Albania
Tel. +355 4 2 280 442/3
Mob. +355 68(69) 40 12 121
Fax. +355 4 2 280 441
www.otpbank.al

faqen e tij zyrtare për të verifikuar përmbajtjen e e-mailit. Nëse merrni një e-mail që ju kërkohen të dhënat e kartës nuk duhet ti përgjigjeni asnjëherë.

12. Kujdes me adresat – Nëse duhet të klikoni në një adresë interneti nga e-mail, thjesht vendosni kursorin mbi të (pa klikuar) për të kuptuar ku do ju dërgoje kjo adresë. Mos klikoni në adresa pa ditur se në cilën faqe do ju dërgojë, faqe të pasigurta mund tju instalojnë një software të padëshirueshëm në kompjuterin tuaj dhe t'ju vjedhin të dhënat tuaja.

13. Shmangni dhuratat virtuale – Nëse një faqe ju ofron një Macbook falas mund t'ju duket gjë e mirë por mundësisht është falso. Në fakt të dhënat e ACI Worlwide tregojne se ofertat për dhuratat virtuale (Gift Cards) kanë mundësi më të madhe për tu hakuar. Shëmbull si mëposhtë:

14. Shmangni klikimet në reklama – Shumë reklama falso mund të instalojnë malware (software që dëmtojnë kompjuterin) në kompjuterin tuaj dhe mund të logohen në llogaritë tuaja dhe ti kalojnë të dhënat tuaja personave të paautorizuar për ti përdorur ato . Mos klikoni reklamat nëse nuk jeni plotësisht të sigurt mbi origjininën e tyre në vecanti në një faqe që nuk keni besim.

15. Kurrë mos blini në Wi-Fi publik – Sidomos për transaksione të sigurta. Ju nuk jeni në dijeni se kush po ju vëzhgon. Ekspertët e mashtrimit dita ditës vijnë me mënyra të reja për të kaluar sigurinë, perdorimi i një hotspot (Wi-FI) ku ju nuk mund të kontrolloni sigurinë e tij është praktikë e keqe.

16. Përdorni PayPal nëse ju jepet mundesia – Nëse në një faqe interneti ju jepet opsioni për të paguar me PayPal përdoreni atë, është më e sigurt. Sipas PayPal-it të dhënat tuaja kur përdoren me ketë ndërmjetes financiar janë shumë të sigurta, pasi ka një nivel të lartë të teknologjisë së fundit të enkriptimit.

OTP Bank Albania
Twin Towers
Bul. "Dëshmorët e Kombit"
Kulla 1, Kati 9
Tirana, Albania
Tel. +355 4 2 280 442/3
Mob. +355 68(69) 40 12 121
Fax. +355 4 2 280 441
www.otpbank.al